



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.724/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2021, mori këtë:

## VEN D I M

**I. REFUZOHET** e pabazuar pjesa e apelit A.nr.724/2021 e datës 29.10.2021, e parashtruar nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj, me të cilën ka kërkuar që të hapen kutit e votimit dhe të rinumërohen, Vendvotimet 2122b/01D, dhe 2101X/01R, si shkak i parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 17.10.2021.

**II. Hudhet i palejuar apeli** Anr.724/2021, e datës 29.10.2021, parashtruar nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj, në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në:

- Vendvotimin 2108b/02D, i vendosur me vendimin e PZAP-it, A.nr.673/2021 të datës 20.10.2021.
- Vendvotimin 2104b/02D, i vendosur me vendimin e PZAP-it, A.nr.675/2021 të datës 20.10.2021
- Vendvotimin 2103b/01R, i vendosur me vendimin e PZAP-it, A.nr.679/2021 të datës 20.10.2021.
- Vendvotimin 2117b/01R, i vendosur me vendimin e PZAP-it, A.nr.678/2021 të datës 20.10.2021.
- Vendvotimin 2126b/01D, i vendosur me vendimin e PZAP-it, A.nr.674/2021 të datës 20.10.2021 dhe
- Vendvotimin 2101x/05R, i vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.676/2021 të datës 20.10.2021, pasi që për këto Vendvotime, janë vendosur me vendimet e PZAP-it, dhe janë çështje e gjykuar.

## A r s y e t i m

Me datën 29.10.2021 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj, në të cilën pretendon se në ditën e votimit me datën 17.10.2021 janë identifikuar nga vëzhguesit e tyre dhe personat e tjerë që kane deklaruar për fletëvotime të pavulosura: në vendvotimin 2108B/02D, 2 fletëvotime te pavulosura; në vendvotimin 2108B/02D, mos barazim nga KVV dhe KKZ ne Skenderaj; në vendvotimin 2104B/02D, 3 fletëvotime te pavulosura; në vendvotimin 2103B/01R, 1 fletëvotime te pavulosura; në

vendvotimin 2117B/01R, 1 fletëvotime te pavulosura; në vendvotimin 2126B/01D, 1 fletëvotime te pavulosura; në vendvotimin 2101X/05R, 1 fletëvotime te pavulosura; në vendvotimin 2122B/01D, 3 fletëvotime te pavulosura; në vendvotimin 2101X/01R, personi i pa autorizuar gjatë numërimit të votave (dëshmi në video dhe foto).

Parashtruesi i ankesës thekson se duke u bazuar në këto fletëvotime të pavulosura kërkon që të bëhet hapja e këtyre kutive dhe rinumërimi i votave në këto kuti të votimeve dhe njëkohësisht të verifikohet saktësia e fletëvotimeve të pavulosura si kanë përfunduar në kutitë e votimit dhe mospërputhja e votave për kryetar dhe subjekte, pasi që siç thekson parashtruesi i ankesës vetëm në vendvotimet e lartcekura gjinden 12 fletëvotime të pavulosura në kutitë e votimeve. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e disa vëzhguesve dhe komisionerëve.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori veprime hetimore lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe nga hetimi i bërë dhe gjeti se në vendvotimin 2122b/01D janë gjithsej 8 fletëvotime të cilat të gjitha janë të vulosura por ato vota janë shpallur të pavlefshme dhe nuk janë numëruar në rezultatin përfundimtar.

Ndërsa Vendvotimi 2101x/01R pretendimi i palës ankuese ka qenë se gjatë numërimit të votave ka qëndruar një person i pa autorizuar. Paneli gjatë hetimit në librin e vërejtjeve nuk është konstatuar ndonjë parregullsi se ndonjë person i paautorizuar ka qëndruar në vendvotim.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se pretendimet ankimore lidhur me Vendvotimet 2122b/01D, dhe 2101X/01R, janë të pabazuara ndërsa pretendimet e pjesës së ankesës lidhur me Vendvotimet 2108b/02D, 2104b/02D, 2103b/01R, 2117b/01R, 2126b/01D dhe 2101x/05R, hedhen të palejuara.

Paneli pasi që vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me vendvotimet 2122b/01D dhe 2101X/01R, vlerësoi se janë të pabazuara, për arsye se lidhur me pretendimet e paraqitura në apel në disa vendvotime janë gjetur fletëvotime të pavulosura, Paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi pasi që nga hetimi i bërë në këto kuti të votimit të sipërcituara dhe gjeti se nuk ka pasur ndonjë fletëvotim të pavulosur si dhe nuk ka qenë asnjë person i paautorizuar gjatë numërimit të votave, ashtu siç pretendon pala ankuese. Paneli vlerëson se apeli i parashtruar nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, nuk është e bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, ku thuhet se “Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.” pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka pasur parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli lidhur me pretendimet në ankesë që kanë të bëjnë Vendvotimet 2108b/02D, 2104b/02D, 2103b/01R, 2117b/01R, 2126b/01D dhe 2101x/05R, i hudhi si të palejuara, për faktin se janë vendosur me vendime të PZAP-it, ku për vendvotimin 2108b/02D është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.673/2021 të datës 20.10.2021, për vendvotimin 2104b/02D është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.675/2021 të datës 20.10.2021, për

vendvotimin 2103b/01R është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.679/2021 të datës 20.10.2021, për vendvotimin 2117b/01R është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.678/2021 të datës 20.10.2021, për vendvotimin 2126b/01D është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.674/2021 të datës 20.10.2021, për vendvotimin 2101x/05R, është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.676/2021 të datës 20.10.2021, pasi që kemi pas të bëjmë me ankuesin e njëjtë, për vendvotime të njëjta dhe me pretendime ankuese të njëjta. Nga kjo gjendje rezulton se apeli i parashtruar nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj lidhur me këto vendvotime të sipërcituara është çështje e gjykuar, ndaj u vendos si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenin 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.724/2021 më datën 31.10.2021.



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*